



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 4307/Prot
11

Tiranë, më 04.06 2026

UDHËZIM

Nr. 10 datë 04.06 2026

PËR

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË FINANCIMIT MBI BAZA
KONKURRUESE TË PROGRAMEVE APO TË PROJEKTEVE KËRKIMORE TË
PARAQITURA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, INSTITUCIONET E
KRIJUARA ME LIGJ TË POSAÇËM, INSTITUTET DHE NJËSITË E VEÇANTA TË
KËRKIMIT SHKENCOR, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 35 të ligjit nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”,

U D H Ë Z O J:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për ndarjen e fondeve publike për institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, për kërkim shkencor, me qëllim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe integrimin në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA).
2. Programet apo projektet kërkimore shkencore të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, financohen nga fondi për projektet kërkimore konkurruese i buxhetit të shtetit, i cili administrohet dhe shpërndahet, mbi bazë thirrjesh dhe procedurash konkurruese, nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
3. Granti “Për punonjës kërkimor-shkencor” akordohet për punonjësit kërkimorë-shkencorë të instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor, për personelin kërkimor të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe për kërkuesit shkencorë të institucioneve të krijuara

me ligj të posaçëm, të cilët, deri në 5 (pesë) vite pas përfitimit të gradës shkencore “Doktor, aplikojnë për financim të programeve apo projekteve kërkimore nëpërmjet institucioneve ku ushtrojnë veprimtarinë kërkimore. Shuma maksimale dhe kohëzgjatja përcaktohen në thirrjen e hapur nga AKKSHI-ja.

4. Granti “Për programe apo projekte kërkimore-zhvillimore” akordohet për grupe kërkimore me jo më pak se 3 (tre) kërkues, të cilët aplikojnë për financim të programeve apo projekteve kërkimore nëpërmjet institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të krijuara me ligj të posaçëm, si dhe instituteve dhe njësisive të veçanta të kërkimit shkencor. Shuma maksimale dhe kohëzgjatja përcaktohen në thirrjen e hapur nga AKKSHI-ja.
5. Granti “Për projekte strategjike kombëtare” akordohet për grupe kërkimore me jo më pak se 5 (pesë) kërkues, të cilët aplikojnë për financim të programeve apo projekteve kërkimore. Këto grupe janë të organizuara në partneritete të përbëra nga institucione të arsimit të lartë, institucione të krijuara me ligj të posaçëm, si dhe institute dhe njësi të veçanta të kërkimit shkencor, ku në partneritet marrin pjesë së paku dy nga këto kategori. Shuma maksimale dhe kohëzgjatja përcaktohen në thirrjen e hapur nga AKKSHI-ja.
6. Granti “Për projekte ndërkombëtare dhe/ose bashkëfinancim me programe të Bashkimit Evropian (BE)” akordohet për grupe kërkimore të përbëra nga institucione të arsimit të lartë, institucione të krijuara me ligj të posaçëm apo institute dhe njësi të veçanta të kërkimit shkencor, të cilët aplikojnë për financim ose bashkëfinancim të projekteve kërkimore që realizohen në kuadër të programeve ndërkombëtare. Ky grant mbështet pjesëmarrjen e institucioneve shqiptare në konsorciume ndërkombëtare, si dhe mbulimin e kostove të bashkëfinancimit dhe shpenzimeve të pranueshme që nuk mbulohen nga programet përkatëse. Shuma maksimale dhe kohëzgjatja përcaktohen sipas marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe dhe rregullave të programit apo projektit kërkimor përkatës.

II. KRITERET PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE APO TË PROJEKTEVE KËRKIMORE

1. Institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, si dhe institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, për financimin e programeve apo të projekteve kërkimore, plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Drejtuesi i programit apo projektit kërkimor i përket të paktën kategorisë “kërkues-shkencor i avancuar”. Ai nuk mund të drejtojë ose bashkëdrejtojë më shumë se një projekt aktiv të financuar nga AKKSHI në të njëjtën kohë;
 - b) në grupin kërkimor të angazuar për programin apo projektet kërkimore, kërkuesit shkencorë të përfshirë i përkasin njëres prej kategorive të punonjësve kërkimorë-shkencorë, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi;
 - c) grupi kërkimor duhet të sigurojë diversitet gjinor, duke synuar një përfaqësim të secilës gjini jo më të ulët se 40%;

ç) Veprimtaria kërkimore-shkencore e drejtuesit dhe grupit kërkimorë të jetë në përputhje me fushën e programit apo projektit kërkimor.

III. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE APO TË PROJEKTEVE KËRKIMORE

1. Vlerësimi i programit apo projektit kërkimor kryhet nga komisioni i ekspertëve për vlerësimin e programeve dhe projekteve kërkimore, i miratuar nga Bordi i Administrimit i AKKSHI-së, bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Vlerësimi bëhet përmes sistemit *Double-Blind Peer Review*, ku vlerësuesit dhe aplikantët nuk njihen, në kushte anonimiteti të plotë, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit.
3. Vlerësimi për programin apo projektin kërkimor bëhet bazuar në:
 - a) Cilësinë shkencore të programit apo projektit kërkimor - deri në 40 pikë, nga të cilat:
 - i. risia, deri në 15 pikë,
 - ii. metodologjia, deri në 15 pikë,
 - iii. qartësia e objektivave, deri në 10 pikë.
 - b) Kualifikimin shkencor të drejtuesit dhe grupit kërkimor- deri në 20 pikë, nga të cilat:
 - i. jetëshkrimi i drejtuesit të programit apo projektit kërkimor, deri në 10 pikë,
 - ii. kategoritë e anëtarëve të grupit kërkimor, deri në 10 pikë,
 - c) Impaktin dhe përdorimin e programit apo projektit kërkimor - deri në 25 pikë, nga të cilat:
 - i. numri i botimeve në revista të indeksuara me faktor të lartë impakti, deri në 10 pikë,
 - ii. patentimi/produkti, deri në 10 pikë;
 - iii. bashkëpunime kombëtare apo ndërkombëtare, deri në 5 pikë.
 - ç) Menaxhimin financiar - deri në 15 pikë, nga të cilat:
 - i. bazuar në kostimin e programit apo projektit kërkimor, deri në 10 pikë;
 - i. planin e rreziqeve, deri në 5 pikë.
4. Vlerësimi i programit apo projektit kërkimor kryhet nga komisioni i ekspertëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të aplikimeve.
5. Të gjitha programet apo projektet kërkimore të paraqitura do të renditen me pikë, bazuar në vlerësimin e kryer nga komisioni i ekspertëve. Programi apo projektet kërkimore me më pak se 70 pikë nuk kualifikohen për financim.
6. Vlerësimet e komisionit të ekspertëve i paraqiten Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t me procesverbalin përkatës të mbajtur dhe listën rankuese të firmosur nga ekspertët

vlerësues. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI përcjell listën për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve fituese në Bordin e Administrimit.

7. Kundër vendimit të vlerësimit paraqitet ankim brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të rezultateve në portalin e AKKSHI-së.
8. Procedura e ankimit bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Rregullat teknike në varësi të fushës së veprimtarisë kërkimore-shkencore, për financimin me fonde publike mbi baza konkurruese të programeve apo të projekteve kërkimore të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, përcaktohen në thirrjen e hapur, si dhe në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe që lidhen ndërmjet AKKSHI-së dhe përfituesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontrollin dhe menaxhimin financiar.
2. Çdo institucion përfitues i nënshtrohet rregullave të raportimit, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI

